



Home > Kronikë

Policia aksion masiv në Shkodër, gjenden drogë dhe armë

07/06/2017 14:46

Policia asgjëson 3600 bimë kanabis në Mat, nuk dihen autorët

Shperndaj ne Facebook

Shperndaj ne Twitter



Policia e Shkodrës ka ndërmarrë një aksion të gjerë anti-kanabis në qarkun e Shkodrës, një ndër më problematikët vitet e shkuara.

Gjatë kontrolleve, janë konstatuar dhe asgjësuar 670 bimë e fidanë narkotikë kanabis sativa, armë zjarri dhe municione luftarake.

Në vendin e quajtur pylli “Nën Maja” në fshatin Ivanaj Njësia Administrative Kastrat, Malësi e Madhe, janë gjetur:

- 1 armë zjarri automatik model 56
- 2 krëhëra
- 50 fishekë
- 55 kapsolla detonatori
- 20 kallepë tritoli
- 15 copë granata
- 2 kutia metalike të mbyllura me ndezësa granate.

Po punohet për identifikimin dhe kapjen e autorëve.

Gjithashtu në vendin e quajtur Qafa e Mollës, Njësia Administrative Gjegjan, Pukë, pronë publike, ambient i hapur, u gjetën të kultivuara dhe u asgjësuan në një parcelë 370 bimë narkotike të llojit Cannabis Sattiva, me lartësi 10-110 cm, si dhe një serë janë gjetur 810 tasa plastik (kubik) ku në 300 prej tyre kishte të kultivuar fidanë, ndërsa në 510 tasa kubik ishin të mbushur me dhe gati për përgatitje të mbjelljes së bimës narkotike.

Për këtë rast janë proceduar në gjendje të lirë për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës” parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, shtetasit:

- F. J, 43 vjeçe, banuese në fshatin Gojan i Vogël Pukë, me detyrë Administratore e Njesisë Administrative Gjegjan, Pukë.
- B. Gj, 47 vjeç, banues në fshatin Rras – Pukë, me detyrë Kryeplak i fshatit Rras.
- T. N, 50 vjeç, banues në fshatin Dom – Pukë, me detyrë Inspektor i policisë pyjore që mbulon Njësinë Administrative Gjegjan, Pukë.

Po punohet për identifikimin dhe kapjen e autorëve.

Leave a Reply

Comment

Name

POST COMMENT

ADVERTISEMENT



LAJMET E FUNDIT



Mesazhi i Yuri Kim: Mos u dorëzoni para atyre që...



Hapen “Ietrat” për vrasjen e Hajdarit, Prokuroria kërko...



Horoskopi ditor për nesër, e Enjte 24 Shtator 2020




“Kemi gabuar me asimptomatikët”, deklarata e...



Listat e hapura/ Hyseni: Opozita pa alternativë dhe n...




‘U përmbyt me 15 minuta shi’, Bylykbashi: Më 2...




Policia kontrolle në të gjithë vendin, arrestohen 24...



“Me lalin më t’mirë që ka Tirana”, Capital T takon...



I shpallur në kërkim dhe i dënuar me 3 vite ...



Doktor, vetëm për “mbështetje ndërkombëtare”...